

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 15 SHKURT 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 15.
FEBRUARA 2008. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR
2008**

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 SHKURT 2008

Seancën e drejtoi, zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar.

Mirë se keni ardhur në seancën e veçantë plenare të pasditës të Kuvendit të Kosovës. Sipas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, keni marrë rendin e ditës dhe në rend dite nuk e kemi një pikë, por i kemi dy.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008,
2. Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe për ART, të cilat, në bazë të rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, bëhen pjesë e buxhetit të Kosovës për vitin 2008.

Në sallë janë të pranishëm 85 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

A miratohet rendi i ditës?
Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? A abstenon ndonjë?
Konstatohet se në mënyrë unanime u miratua rendi i ditës.

Fillojmë me pikën e parë:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në cilësinë e Komisionit përgjegjës raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci, që të arsyetojë raportin me rekomandime.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,
Bazuar në Kreun 5a dhe b të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Kosovës dhe në rregullat 35, pikat 10 dhe 51.2 dhe 3 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 15.2.2008, pas leximit të parë në seancën plenare ka shqyrtuar Projektligjin për miratimin e Buxhetit të

Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008 dhe sjell këtë rekomandim.

1. Pas leximit të parë në seancë dhe diskutimeve në Projektligjin për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara,
2. Komisioni rekomandon miratimin e buxheteve të propozuara për agjencionet e pavarura: Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe Autoritetin Rregullator të Telekomunikacionit dhe kërkon që të njëjtat buxhete të inkorporohen në tabelat buxhetore të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës.

Besoj dhe shpresoj që do t'i miratojmë amendamentet. Komisioni ka bërë nja 10 amendamente, me sa më duket mua. Nuk jemi lëshuar shumë në çështje, më tepër ndoshta janë çështje teknike, të cilat besoj që nuk do të na nxjerrin shumë probleme gjatë miratimit të tyre.

Faleminderit!

KRYETARI: Kërkohet një deklaram i shefave të grupeve parlamentare.
Fillojmë me shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotin Ramë Buja.

RAMË BUJA: Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti Kryetar dhe zoti Kryeministër,

Duke pasur respekt për lodhjen tuaj, unë do t'i bie shkurt sepse konsideroj që në seancën e parë ose të mëparshme përjetuam një katarsis, siç thuhet, të fakteve, të ndjenjave edhe të tjera, dhe besoj që jemi ngopur. Ne si grup parlamentar i mbështesim edhe diskutimet, që në shumicë absolute konsideroj se ishin përmbajtjesore, të argumentuara dhe të mira, natyrisht.

Mbështesim edhe rekomandimet e komisionit funksional profesional dhe shumë argumentues, pra mbështesim tërësisht Projektligjin për Buxhetin e vitit 2008.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! LDK-ja, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka marrë amendamentet e Komisionit për Buxhet, i ka shqyrtuar, i përkrah amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe fton anëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së që t'i votojnë amendamentet dhe ta votojnë në përgjithësi, në fund, ligjin për miratim.

Po ashtu, jemi marrë vesh që kërkesat të cilat kanë ardhur të shkruara nga pjesëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së, në formë të amendamenteve, për shkak të shpejtësisë së vendimit do të merren në konsiderim me rastin e rishqyrtimit të buxhetit. Këtë

marrëveshje e kemi bërë edhe me pjesën e ekzekutivit për sektorët përkatës, edhe me pjesën e Kuvendit.
Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Shatri!
Fjalën e ka kryetari i Grupit të AKR-së, ose kryetari i Partisë, Behxhet Pacolli.

BEHXHET PACOLLI: I nderuari Kryetar,
I nderuari zoti Kryeministër, ministra, kolegë,
Unë isha dje në këtë Komision kur u diskutua për ART-në. Ne, normalisht, si opozitë konstruktive miratojmë rekomandimet, mirëpo, ART-ja kërkon një investim për blerjen e një sistemi për monitorimin e mediave në Kosovë, i cili është kuotuar diku me afro 2.800.000 euro dhe besoni se është një impiant që nuk kushton aq. Është një impiant që kushton diku kah 800.000, maksimum 900.000 euro. Në mënyrë profesionale e kam verifikuar dhe ne këtë duhet ta marrim me rezervë. Mirëpo, nga ana tjetër, për këtë impiant nuk janë konsideruar shpenzimet shtesë. Shpenzimet shtesë janë, prapë rrjedhin prej eksperiencës profesionale, është qiraja e transponderit në satelit që çdo 3 muaj kushton diku kah 14.000 euro, që nuk janë paraparë këtu. Prandaj, kjo rezervë duhet të shënohet diku. Përndryshe, ne i miratojmë rekomandimet.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Dua ta marrë fjalën si kryetar i Komisionit.
Kërkesa për investime kapitale të këtij organi rregullativ nuk është 2 milion euro, por është 1 milion e 600 mijë me të gjitha ato që potencohen, prandaj, të mos krijojmë një saktësi në interpretimin e këtyre. Si anëtarë të Komisionit kemi edhe qëndrimin e autoritetit rregullativ që rreth implementimit të këtij projekti duhet të marrin pjesë edhe Qeveria edhe Kuvendi e jo vetëm ART-ja, prandaj, si Komision nuk e kemi konsideruar si kërkesë të madhe të këtij organi rregullativ dhe kemi miratuar buxhetin e këtij organi ashtu siç e kemi prezantuar këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së. A do ta marrë fjalën dikush në vend të Ardianit? Urdhëro, zoti Maloku!

NAIM MALOKU: I nderuari zoti Kryetar, zoti Kryeministër,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh faktin se Qeveria e Kosovës e ka sjellë këtë projektbuxhet për këtë vit pa program qeveritar, duke marrë parasysh faktin se vërejtjet e paraqitura nga grupi ynë parlamentar në leximin e parë nuk janë marrë parasysh nga Komisioni për Buxhet dhe të përfshira në këto amendamente që na ofrohen tani për miratim. Grupi Parlamentar i AAK-së do të votojë kundër këtij buxheti.

KRYETARI: Faleminderit!
E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Zoti Kryetar,

Ne i morëm këto amendamente, të cilat nuk dallojnë shumë prej konceptit të cilin e ka adresuar Qeveria sa i përket këtij projektligji për buxhet. Mirëpo, ajo çka është esenciale, në këtë rast, në shikim të parë e vëren që edhe këto amendamente janë në kundërshtim të plotë me qasjen të cilën e ka adresuar Kryeministri sa u përket investimeve kapitale. Kryesisht, kjo adresohet në amendamentet 7 dhe 9. Argumenti i dytë është se amendamenti 9 bie ndesh dhe në kundërshtim të plotë edhe me vendimin e seancës plenare dhe me vendimin e Kuvendit të Kosovës, që e ka nxjerrë në mandatin e kaluar. Prandaj, mbi këtë bazë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, do të votojë kundër.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS-ja, do të thotë, janë këtu, por kanë treguar se do të votonin për buxhetin.

Në radhë është Grupi Parlamentar “7+, shefi i Grupit, zoti Haxhi Merxha.

HAXHI MERXHA: Faleminderit, i nderuari Kryetar i Parlamentit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Ju përshëndes juve dhe stafin tuaj. E përshëndes Kryeministrin me stafin e tij, po ashtu, zonja dhe zotërinj që deri më tash pritëm ta kryejmë më shpejtë, ja që erdhi koha ta kryejmë.

Ne, Grupi “7+” e pranojmë, gjithqysh Buxhetin financiar për 2008, ashtu siç ishte, sepse nuk ka mundur Qeveria për një kohë të shkurtër të na i plotësojë të gjitha gjërat që po i kërkojmë, sepse për 1 muaj ose 6 javë asgjë nuk bëhet, po ata kanë dashur të thonë ashtu. Urime atyre, ne po e pranojmë.

Faleminderit!

KRYETARI: Ibrahim Makolli. Është shënuar emri juaj. A dëshironi fjalën?

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti Kryetar, këtu, në kërkesën dhe arsyetimin e Komisionit për Buxhet, po shoh edhe kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Energji, sikurse edhe në kërkesën e Zyrës së Rregullatorit të Telekomunikacionit, që bie ndesh ...

KRYETARI: A e lëmë për pikën e 2-të të rendit të ditës, kur i kemi ato dy agjenci.

IBRAHIM MAKOLLI: Po flasim për rekomandimet e Komisionit, apo?

KRYETARI: Po e kemi lënë pikën 1 janë amendamentet, kurse pika 2 rekomandimet.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti Kryetar, pikërisht, për amendamentet po flas.

KRYETARI: Mirë!

IBRAHIM MAKOLLI: ... që bien ndesh, kujtoj këto mëditje dhe paga që parashihen për këta zotërinjtë ose zonjat e këtyre agjencive, janë në kundërshtim me ato çka kjo Qeveri ka deklaruar dhe konsideroj se si të tilla nuk mund të pranohet, sikurse që kam

parasysh se kemi agjenci të tjera të tilla, të cilat do të duhej të trajtoheshin në mbështetje të ligjit.

Si deputet i këtij Parlamenti dhe si shef i Grupit Parlamentar të AKR-së, në asnjë rast nuk do të pajtohesha me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa sa u përket këtyre dy çështjeve, të cilat po i debatojmë. Janë absolutisht të paarsyeshme dhe në kundërshtim me të gjitha ato të cilat janë proklamuar deri më sot.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Vërtet, para shqyrtimeve të çdo çështjeje, në këtë rast edhe të buxheteve të këtyre zyrave, do të ishte mirë që para vetes të kemi Ligjin e Telekomunikacionit që rregullon mënyrën e financimit të këtij agjencioni. Po ashtu, do të duhej të kishim para vetes edhe Ligjin për Zyrën e Energjisë që rregullon çështjen e financimit dhe, siç thoni, edhe të pagave dhe të mëditjeve të këtyre zyrave.

Ne kemi vepruar në përputhje me këto dy ligje që rregullojnë edhe mënyrën e pagesave të bordeve të këtyre agjencioneve, prandaj ne nuk kemi mund të jemi në kundërshtim me ligjet. Urdhëroni, t'i ndryshojmë ligjet dhe të bëjmë një sistem unik për rregullimin e këtyre çështjeve të pagave dhe të mëditjeve të këtyre zyrave.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Koci!

Kalojmë në miratimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Në faqen 8 e keni.

Lus deputetët të përgatiten për votim.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, “Për” kanë votuar 63 , “kundër” 9 dhe 3 abstenime.

Konstatohet se miratohet amendamenti numër 1.

Në të njëjtën faqe është edhe amendamenti 2.

Lus regjinë që të përgatitet për votim:

Votojmë tash:

Me 63 vota ” për “, 11 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti numër 2.

Në radhë është amendamenti 3.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, 9 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti numër 3.

Në faqen 17 keni amendamentin numër 4.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Me 74 vota “për”, 8 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti numër 4.

Në faqen 25 keni amendamentin numër 5.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tani:

Me 68 vota “për”, 10 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti nr. 5.

Në faqen 37 është amendamenti numër 6.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Me 72 vota “për”, 8 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet edhe amendamenti numër 6.

Në faqen 38 keni amendamentin numër 7.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Anulohet votimi.

Fjalën e ka deputeti Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit!

Jemi pajtuar që të sigurohet një fond në formë të transferit për Zyrën e Kryeministrit. Në bisedë me ministrin e Financave jemi pajtuar që burimi i këtyre mjeteve mos të hiqet nga 50 milionëshi i autostradës, por që nga rezervat e ministrit të ndahet 1 milion, kurse rezerva e ministrit, me rishikim, mund të rimbushet. Kemi pasur një pajtim, në qoftë se ministri del e arsyeton, unë për ministrin po flas dhe mendoj që mund ta rregullojmë. Faleminderit!

KRYETARI : E ka fjalën kryetari i Komisionit, Gani Koci,

GANI KOCI: Unë jam i shqetësuar pak me qëndrimet e Haki Shatrit jo vetëm sot këtu, por edhe gjatë gjithë kohës së punës edhe në Komision atje, po sigurisht që do të vijmë në veti.

Ne kemi kërkesën e Kryeministrit, kemi shqyrtuar kërkesën e Kryeministrit për këtë bartje, për këtë transfer dhe ai përcakton qartë nga cili kod i merr dhe ku i vendos. Ne kemi vepruar mbi bazën e kësaj kërkesë. Komisioni ka vepruar dhe ka miratuar kërkesën nga Zyra e Kryeministrit lidhur me këtë transfer. Prandaj, bisedat private me ministrin e Financave e të tjera nuk duhet të na sillen në Kuvend, por atje në Komision.

KRYETARI: Faleminderit!

Ne votojmë tekstin e ofruar në amendamentin numër 7.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 14 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti nr. 7.

Po në të njëjtën faqe e keni amendamentin nr. 8

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Me 70 vota “për” 10 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti nr. 8.

Në të njëjtën faqe e keni amendamenti nr. 9.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, 12 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 9.

Lus deputetët që të deklarohen për tekstin në tërësi të Projektligjit të buxhetit për vitin 2008, me ndryshimet e bëra.

Lus regjinë që të përgatitet për votim.

Votojmë tash.

Me 73 vota “për”, 13 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet Buxheti për vitin 2008.

(Duartrokitje)

I kemi edhe dy rekomandime, për Zyrën e Rregullatorit dhe ART-në - pika e dytë e rendit të ditës.

I hedhim në votim.

Lus regjinë, që të përgatitet për votim.

Votojmë tani.

Me 64 vota “për”, 13 “kundër” dhe 7 abstenime, janë miratuar edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryeministri, zoti Hashim Thaçi e ka kërkuar fjalën.

Urdhëro, zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Do të jem shumë i shkurtër.

Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit dhe respekt për të gjitha opinionet, për të gjitha rekomandimet, këshillat dhe sugjerimet, për mbështetjen e plotë për Projektligjin. Natyrisht, edhe vërejtjet janë të mirëpritura edhe sugjerimet do të respektohen. Para së gjithash, dua t’ju falënderoj se është treguar një unitet i qëndrueshëm në mbështetje të Buxhetit të ri të konsoliduar të Kosovës nga partnerët në koalicion. Faleminderit edhe nga opozita demokratike, AKR-ja dhe LDD-ja. Vlerësim edhe për qëndrimin e veçantë, por të vetmuar të AAK-së. Ne duhet të vazhdojmë të jemi aktiv edhe këto ditë. Natyrisht, jam optimist se si gjeneratë, por edhe në të njëjtën kohë si strukturë e deputetëve, e qeveritarëve, jemi me fat që po i kalojmë bashkërisht edhe këto ditë të rëndësishme për vendin tonë.

Ju faleminderit e respekt!

KRYETARI: Ju faleminderit Kryeministër, faleminderit deputetë që morët pjesë në debat!

Kjo seancë plenare mori fund.

Mirupafshim, në seancën solemne!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës